



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI**

Numri i lëndës: 2022:120763

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474482

**PPP.nr.21/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË V.**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë rr."Nëna Terezë" nr.36, dhe debitorit T.U.nga S.Komuna e V., duke vendosur për afatshmërinë e ankesës së ushtruar me datë 05.01.2024, nga ana e kreditorit, për vlerën e borxhit prej 1,560.11 €, jashtë seancës gjyqësore me datë 18.03.2024, bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** ankesa e kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në Prishtinë, si e pas afatshme.

**A r s y e t i m**

Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në V., PPP.nr.21/2019, i datës 14.12.2023, gjykata e ka miratuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit T.U.nga S.e Komunës së V., duke e detyruar debitorin që kreditorit KEK, t'ia paguaj borxhin për shpenzimin e energjisë elektike në shumë prej 47.25 euro, ndërsa e ka shfuqizuar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr.459/2018, të datës 20.12.2018 të nxjerr nga përmbartuesi privat P.X.me seli në Gjilan, për shumën e borxhit prej 1,535.11 euro.

Kreditorit KEK, iu ishte dorëzuar Aktvendimi PPP.nr.21/2019, i nxjerr me date 14.12.2023, të cilin vendim e kishte pranuar me datë 28.12.2023.

Kreditori KEK i pa kënaqur me këtë vendim, kishte ushtruar ankesë me datë 05.01.2024 (ditë e premtë), datë kjo kur ankesa ishte dorëzuar përmes postës në Prishtinë.

Afati për paraqitjen e ankesës kundër aktvendimit në rastin konkret ishte 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit, andaj kreditori kishte ushtruar ankesë në ditën e 8-të, pasi kishte pranuar vendimin, ndërsa theksojmë se dita e enjte e datës 04.Janar 2024 ishte ditë pune.

Me nenin 77.2. të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) thuhet: *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*.

Andaj, gjykata konform nenit 77, të LPP-së, përshtatshmërisht me nenin 17 të LPK-së, lidhur me nenin 186, paragrafi 1 të LPK-së, e hedhë poshtë ankesën e kreditorit si të jashtë afatshme.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:120763  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05474482

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NE V.  
PPP.nr. 21/2019  
Më:18.03.2024

G j y q t a r i  
Raif Fazliu

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.